ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër**: Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**IL-25-1028-5-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Rindertimi segmenteve të pjesëve të Kanalit Besi-Graçankë"

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

Grupi i "Conex"L.L.C & "Pepa Group"sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë *10000*

(Vendi) *(Kodi postar)*

049500080 *N/A*

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Dardan Fetahi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

l.l.c.conex@gmail.com
(Adresa elektronike)

05.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 21.02.2025 Data e hapjes së ofertave: 24.03.2025 Njoftimi mbi vendiminB58 :14.04.2025 Kërkesë për rishqyrtim:22.04.2025 Qasja dokumentacion-kufizuar-18.04.2025 Lloji Kontrates:Punë Vlera e Kontratës:450,000.00Euro Kërkesa për rishqyrtim dt.22.04.2025 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:23.04.2025

CONEX
L.L.C.-PRISHTINE-S.H.P.K.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP- së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP- së
Neni 56 i LPP- së
Neni 59 i LPP- së
Neni 60 i LPP- së
Neni 69 i LPP- së
Neni 72 i LPP- së
Neni 34 i Rregullores për Prokurim Publik 001/2022
Neni 40 i Rregullores për Prokurim Publik 001/2022
Neni 7 i Rregullores për Prokurim Publik 001/2022 , paragrafi 7.6 dhe 7.6.5

CONEX

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë në KRPP është bëre me datën 21.02.2025, ndërsa procesverbali i hapjes ka qenë me datën 24.03.2025, ndërsa B58-Njoftimi mbi vendimin ka qenë me datën 14.04.2025, ku autoriteti ka shpallur fitues: PLURAL SH.P.K & PRO &CO Group sh.p.k & Arbor Group sh.p.k me çmim prej 419,970.22euro, pra 32,290.32 me shtrejtë se oferta jonë nga: Conex L.L.C &Pepa Group sh.p.k, prej 387,679.30euro. AK neve si OE na ka eleminuar me një arsyetim shumë të pa bazuar dhe të paqëndrueshëm:
Arsyeja e eliminimit është dhënë në këtë mënyrë:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

- Komisioni konstaton se Grup i Operatorëve Ekonomik CONEX L.L.C.; Pepa Group: eshte i paparanueshem për këto arsye:
- ISO Certifikatat nuk I ka per produkte, sic kerkohet ne DT por I ka te kompanise, qe jane jo ne pajtueshmeri.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë Grupit të Operatorëve Ekonomik PLURAL SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K.; ARBOR GROUP SH.P.K.: me vlerë totale të ofertës 419,970.22 EURO.

Sa i përket kërkesës teknike profesionale pika 2.4 AK ka kërkuar: *OE duhet te vertetoje se produktet e ofruara per kryerjen e pozicionev te punes jane te certifikuar me ISO 9001 2015; ISO 14001 2015 dhe 45001 2018,si dëshmi ka kërkuar:* **Kopjet e certifikatave ISO te kërkuara,**
Gjatë hartimit dhe specifikimit të dosjes së tenderit AK ka parashtruar kërkesa të paqartë ose në mungesë të njohurive ose me tendenca për favorizim dhe eliminimin të OE në kundërshtim me LPP dhe Rrpp, e që një lëshim i tillë nuk është vërejtur as nga KRPP, që pasi kërkesa të tilla mund të ndikojnë në dëmtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Gabimi nga AK lidhur me kërkesën: Ka formuluar kërkesa të paqartë dhe në kundërshtim, kërkesa lidhur me ISO: e formuluar nga AK:

Formulimi i AK(pasaktë)"OE duhet të vërtetojë se produktet e ofruara për kryerjen e pozicioneve të punës janë të certifikuar me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018."

CONEX

Formulimi i saktë nga ana terminologjisë teknik: "Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se kompania e kontraktuar për realizimin e punimeve zotëron certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, të vlefshme për fushën përkatëse të veprimtarisë."

Duke u mbështetur në analizën tonë gjuhësore dhe teknike, vlerësojmë se formulimi i kërkesës në dokumentet e tenderit: *"OE duhet të vërtetojë se produktet e ofruara për kryerjen e pozicioneve të punës janë të certifikuar me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018"*, është jo i drejtë dhe i pasaktë, pasi këto standarde ndërkombëtare nuk aplikohen për produkte, por mbi sisteme të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë, që i përkasin vetë kompanive realizuese.
"OE duhet të vërtetojë se produktet e ofruara për kryerjen epozicionevetë punës janë të certifikuar me ISO..." është formulim i pasaktë, pasi lë të kuptohet gabimisht që certifikatat ISO aplikohen mbi produkte ndërtimi (p.sh. beton apo armaturë), gjë që nuk përputhet me natyrën e këtyre standardeve. Nga njohuritë që ne i kemi dhe nga përvoja me këto punë e dimë se **nuk certifikohen produktet**, por **proceset dhe menaxhimi i kompanisë që i prodhon ose i përdor ato,** pra gabimi qëndron në **keqinterpretimin e fjalës "produkt"** në kontekstin e ISO, sepse Përdorimi i termit "produkt i certifikuar me ISO 9001" është **terminologji jo e saktë**, sepse ky standard nuk lidhet me produktin si objekt, por me cilësinë e proceseve të punës, andaj ky **gabim i natyrës tekniko-ligjore dhe gjuhësore**, ka dërguar në interpretim të gabuar gjatë vlerësimit të ofertave, andaj fjala "produkt" me "ISO" ka dallime, sepse këto **standardet ISO** nuk certifikojnë **produkte**, por certifikojnë **kompanitë për mënyrën se si ato i menaxhojnë proceset**, cilësinë, mjedisin dhe sigurinë,

Dallimi:

Produkt	*Çfarë prodhohet/ofrohet*	Një send ose material i gatshëm për përdorim
Certifikuar	*Vula e cilësisë/verifikim*	Një vërtetim zyrtar që plotësohen standarde të caktuara

Andaj ne si OE kemi paraqitur ISO konform terminologjisë së saktë, rregullatives ligjore dhe në përputhje me kërkesën e dokumenteve të tenderit, ku kemi paraqitur certifikatat ISO të kompanisë që do të realizojë punimet, të cilat janë të vlefshme, të njohura ndërkombëtarisht dhe të lëshuara nga një trupë certifikuese e akredituar. Kompania jonë përmbush të gjitha kërkesat për fushën përkatëse të veprimtarisë, duke përfshirë ndërtim, përgatitje dhe montim të punimeve të kërkuara në tender (punime dheu, beton, armaturë, etj.)n dhe këto shënohen nëpër Iso standarde. Pra kriteri nga ana jonë është plotësuar konform dosjes së tenderit, ndërsa AK ka krijuar diskriminim në vlerësim, prandaj kërkojmë me mirëbesim nga OSHP-ja që të bëhet një analizë e qartë e kërkesës dhe dokumentacionit të ofruar nga ne me qëllim që të arrihet një përfundim i saktë dhe i drejtë i gjendjes reale.

Neve nuk na është lejuar qasje e plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ku me datë. 18.04.2025-14:45 kemi pasur qasje të kufizuar, pasi që sipas dosjes se tenderit të dorëzuar nga OE-Fitues, ka plotësuar Aneksi 3 -Sekret Afarist.

OE ka keqpërdor mundësinë e sekretit afarist në kundërshtim me dispozitat e **nenit 7 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022**, duke klasifikuar në mënyrë të

CONEX

përgjithësuar dokumente si "informata sekrete afariste", përmes **Aneksit 3**, pa dhënë arsyetime të justifikuara.

Kujtojmë se, sipas **nenit 7.6.5**, jo të gjitha dokumentet e përmendura në nenin 68 dhe 69 të LPP-së mund të klasifikohen si sekrete afariste, në veçanti kur ato përmbajnë: Informata për stafin teknik, Pajisje në pronësi të OE-së, Lista e përvojës së mëparshme në projekte publike, apo Certifikata dhe licenca të lëshuara nga organe shtetërore, duke krijuar një mbylljen të procesit të prokurimit pa vërejtur gabimet që AK ka mundur të bëje gjatë vlerësimit, andaj me qenë se Iber Lepenc identifikohet si institucion publik, atëherë Duke u bazuar në të drejtën ligjore për qasje në dokumente publike sipas **Ligjit Nr. 06/L-081**, si dhe në **nenin 65, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës**, paraqesim këtë **pretendim ankimor lidhur me refuzimin ose kufizimin e qasjes së plotë në dokumentacionin e prokurimit**, për një projekt të financuar nga fonde publike, për të cilin kemi marrë pjesë si Operator Ekonomik, duke pasur parasysh se sipas **nenit 17, paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-081**, thuhet qartë se:

"Qasja në dokumente publike gjithnjë lejohet, nëse dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me shpenzimet e parasë publike."

Duke qenë se projekti në fjalë është i financuar nga buxheti publik, kërkesa jonë për qasje në dokumentet e prokurimit është e mbështetur në ligj dhe nuk mund të refuzohet, përveçse për arsye specifike të justifikuara nga autoriteti kontraktues, e sipas **nenit 3, paragrafi 1.1.8 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike**, "Iber Lepenc" klasifikohet si kompani publike, për shkak të pronësisë nga Republika e Kosovës dhe ushtrimit të funksioneve publike, dhe për rrjedhojë është subjekt i këtij ligji, edhe pse OE ka aneksi 3, i lejohet OE që ta shoh qasjen në zyrën e prokurimit, me zyrtaren e prokurimit po ashtu edhe me zyrtaren për qasje ne dokumentacion zyrtar, e që në këtë form mund të krijohet një vlerësim i drejtë dhe jo i njëanshëm, e që një gjë e tillë, autoriteti kontraktues nuk ka përgatitur versionin e pastruar të **dokumentacionit** për të ndarë ato pjesë që s'përbëjnë sekret afarist dhe që duhet të jenë të qasshme për publiku. Sipas **nenit 7.6.3 të Rregullores së Prokurimit Publik**, autoriteti kontraktues është i detyruar të ofrojë qasje në **versionin e pastruar të dokumentacionit**, menjëherë pas publikimit të njoftimit për vendim. Kjo nuk është zbatuar, duke shkaktuar mungesë transparence dhe pengim të të drejtës sonë për të mbikëqyrur drejtësinë e procesit të prokurimit, andaj përmes kësaj ankese kërkojmë nga OSHP-ja që të detyrojë AK që të rishqyrtojë dokumentacionin e klasifikuar si sekret afarist;

- Të bëjë ndarjen dhe pastrimin e dokumenteve në përputhje me Rregulloren e Prokurimit Publik;
- Të na mundësojë qasje në të gjitha dokumentet që **nuk përmbajnë informata sensitive** dhe nuk bien nën mbrojtjen e nenit 68 e 69 të LPP-së;
- Në të kundërtën, do të jemi të detyruar të ndjekim rrugët institucionale për trajtimin e këtij rasti si dhe ta paraqesim çështjen në instancat përkatëse ligjore si shkelje e të drejtës kushtetuese për informim dhe transparencë

Poashtu OE-Fitues: PLURAL SH.P.K & PRO &CO Group sh.p.k & Arbor Group sh.p.k me çmim ofertues prej 419,970.22euro, Bazuar në dokumentacionin që është bërë i

CONEX

qasshëm për OE-në tonë, kemi konstatuar se **Aneksi 3 (Deklarata për Sekretin Afarist)**, është përmbushur dhe nënshkruar nga z. **Albin Thaçi**, në emër të kompanisë **Plural Sh.p.k.**

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	PLURAL SH.P.K
Adresa e plotë:	LAGJJA EMSHIR FATIME HETEMI, PRISHTINE
I përfaqësuar nga:	
Emri:	ALBIN THAQI
Pozita:	PERSON I AUTORIZUAR
Nënshkrimi:	
Data:	24.03.2025
Vula:	

Megjithatë, përmes verifikimit zyrtar në faqen e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), rezulton se për këtë subjekt afarist, me **numrin përkatës të biznesit dhe adresën e njëjtë**, **personi i vetëm i autorizuar ligjërisht është z. Fatmir Salihu**.

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Shqipe	Salihu	Drejtor	Sipas ligjit dhe statutit.
Fatmir	Salihu	Përfaqësues i autorizuar	Sipas ligjit dhe statutit.

Kjo do të thotë që: Z. Albin Thaçi **nuk figuron si person i autorizuar zyrtarisht** për të përfaqësuar Plural Sh.p.k në marrëdhënie ligjore dhe kontraktuale; Dokumenti në fjalë është nënshkruar nga një person **pa autorizim të vlefshëm ligjor**, duke e bërë atë **të pavlefshëm për nga përmbushja formale dhe ligjore,** e ku sipas LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik:

Të gjitha dokumentet që kanë karakter deklarativ ose ligjor duhet të **nënshkruhen nga përfaqësuesi i autorizuar ligjërisht** i operatorit ekonomik.

Mungesa e përmbushjes së vlefshme të këtij dokumenti përbën **shkelje të drejtpërdrejtë të kërkesave të dosjes së tenderit**, dhe si rrjedhojë, e bën **dokumentin e pavlefshëm**.

Ky OE është dashur të eliminohet nga konkurrenca e jo të shpallet fitues i këtij tenderi.

CONEX

Nëse një dokument është i pavlefshëm, nuk mund të merret si bazë për **mohim të qasjes**, pasi nuk ka fuqi juridike që ta mbrojë atë përmbajtje si "informacion konfidencial", andaj konform kërkesës tonë kërkojmë nga OSHP:

- **Të analizojë vlefshmërinë e Aneksit 3** të paraqitur nga operatori Plural Sh.p.k., meqenëse është nënshkruar nga një person pa autorizim të regjistruar.
- **Të konsiderojë se mbrojtja e dokumentacionit si "sekret afarist" është e pavlefshme**, për shkak se dokumenti që kërkon mbrojtje është në kundërshtim me LPP-në dhe rregullat për përmbushje të saktë të dokumenteve.

Pasi që ANEKSI 3 është i pavlefshëm, të detyrojë AK-së të na mundësojë qasje të plotë në dokumentet përkatëse të ofertës së operatorit në fjalë, pasi mungesa e vlefshmërisë së Aneksit 3 e heq bazën ligjore për kufizim të qasjes duke mos garantuar qasje në dokumentacionin përkatës në bazë të një dokumenti të pavlefshëm, Autoriteti Kontraktues rrezikon të veprojë në **kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës**, i cili garanton të drejtën për **informim dhe qasje në dokumente publike**.

Për më tepër, një veprim i tillë përbën edhe **shkelje të Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike (Nr. 06/L-081)**, si dhe bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **Ligjin për Prokurimin Publik**, për sa i përket përmbushjes së dokumenteve dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë

Andaj duke u bazuar në raportin e vlerësimit të ofertave për procedurën e sipërpërmendur, si dhe në dispozitat përkatëse të **Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës** dhe **rregulloret zbatuese**, paraqesim këtë shkresë me qëllim të evidentimit të papërputhshmërive të vërejtura në vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender dhe të kërkesës sonë që të konsiderohet oferta jonë si më e përshtatshmja.

Për operatorët ekonomik tjerë të cilët janë më të lirë, ne pajtohemi e arsyet e eliminimit dhe po ashtu ato arsye janë edhe pretendime tona ankimore.

<u>1. Operatori ekonomik më i lirë – VIA EGNATIA Sh.p.k.</u>

Sipas raportit të vlerësimit, ky operator nuk ka përmbushur **kriterin e përvojës së ngjashme**, i cili kërkon që:

"Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses punë të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Vlera e punëve të ngjashme duhet të mbërrij shumën 300,000.00 EUR."

Për më tepër, ky operator **nuk ka përmbushur kërkesën për makineri përkatëse**, në përputhje me kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit.

CONEX

Bazuar në këto dy kritere të domosdoshme, **operatori rezulton të jetë i papërgjegjshëm** dhe si i tillë duhet të skualifikohet.

2. Operatori i tretë më i lirë – NBT-ING

Në raportin e vlerësimit, është deklaruar qartë se edhe ky operator **nuk ka prezantuar makinerinë adekuate**, sipas kërkesave të dosjes së tenderit, dhe si rezultat është **shpallur operator i papërgjegjshëm**.

3. Operatori i dytë më i lirë – AGRO INVEST 1

Neve nuk na është lejuar qasje në ofertën e këtij OE, oprandaj kemi shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së.

Me këtë veprim nuk është respektuar nenin 10 dhe 11 i LPP-së, e po ashtu janë bërë shkelje ligjore të LPP-së, të LIGJIT NR. 06/L-081 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE dhe po ashtu janë bërë shkelje edhe të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

OE në fjalë ka plotësuar aneksin 3 për sekret afarist, mirëpo në asnjë mënyrë nuk kanë arsyetuar kërkesën për sekret afarist por vetëm e kanë cekur se dokumentet e nenit 68 dhe 69 janë sekret afarist.

Sipas nenit 11 paragrafi 3 të LPP-së, kërkesa duhet të arsyetohet dhe të parashtrohen arsye konkrete, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të grupit të operatorëve ekonomik.

Ky OE nuk ka dhënë ndonjë dëshmi apo arsye se qasja në dokumente do ti dëmtonte interesat materiale dhe komerciale të tij, prandaj këto deklarata të grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk mund të merren parasysh sepse nuk janë konform kërkesave ligjore.

Ju sqarojmë se autoriteti kontraktues duhet të klasifikojë si sekret afarist informatat dhe dokumentet nëse janë përmbushur tri kriteret e përmendura në nenin 11.3 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues është i obliguar ti respektojë të gjitha dispozitat e LPP-së dhe në këtë rast nenin 10 dhe 11 të LPP-së, dhe kur ka një deklaratë për sekret afarist duhet të analizohet dhe nëse nuk janë përmbushur të tri kushtet e nenit 11.3 të LPP-së, atëherë nuk duhet të klasifikohen sekret afarist dokumentet tilla. Mbi të gjitha, edhe nëse mund të klasifikohen sekret afarist disa dokumente, atëherë duhet të përgatitet versioni i pastruar sipas nenit 11.4 të LPP-së mirëpo që AK-së këtë veprim nuk e ka ndërmarr.

Mos përgatitja e versionit të pastruar nga ana juaj, tregon që ju me çdo kusht po mundoheni të favorizoni OE e rekomanduar për kontratë duke u munduar të fshehni dokumentet e këtyre grupeve të operatorëve ekonomik.

CONEX

Edhe pse nuk na është lejuar qasja në dokumentet e ofertës së këtij operatori për shkak të ndalimit të përdorimit të USB-ve në institucionet publike, dëshirojmë të theksojmë se ky OE është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

Bazuar ne dilema dhe dyshime **të arsyeshme** dhe analizës së burimeve të hapura, konsiderojmë se **AGRO INVEST 1 nuk ka kontrata të ngjashme për periudhën 3-vjeçare**, siç kërkohet në dosjen e tenderit;

Bazuar ne dilemma dhe **dyshime të bazuara** se operatori nuk ka prezantuar as **makineritë e kërkuara**, në përputhje me specifikimet teknike të dosjes.

Duke qenë se:Operatori i parë dhe i tretë janë **shpallur të papërgjegjshëm**,Për operatorin e dytë ekzistojnë **dyshime të arsyeshme mbi përmbushjen e kritereve të rëndësishme**,Ndërsa **oferta jonë është e katërta më e lirë dhe përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit**,atëherë **ne konsiderojmë se jemi operatori i parë në renditje që përmbush kriteret në mënyrë të plotë**, dhe si rrjedhojë, duhet të shpallemi si **operatori më i suksesshëm**, në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe parimet e transparencës, barazisë dhe trajtimit të drejtë.

Bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga OSHP-ja që **analizoje raportin e vlerësimit**, me fokus të veçantë në përmbushjen e kritereve nga ana e 3 operatorëve më të lirë në renditje;Që, në rast të konfirmimit të papërgjegjshmërisë së tyre, të **vazhdohet me ofertën tonë si më e përshtatshmja në përputhje me vlerën më të ulët dhe përmbushjen e plotë të kritereve**;Të respektohen dispozitat e LPP-së, përfshirë të drejtën për qasje të plotë dhe për trajtim të barabartë në këtë proces.

Në këtë tender, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse ne jemi eliminuar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimti për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri për dhënie të kontartës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Autoriteti kontraktues nuk ka pasur paraysh edhe parimin e ekonomicitetit sepse ka shpallur fitues një OE i cili është në vlerë pej 32 mijë euorve më shtrenjtë se sa oferta jonë, prandaj me këtë rast po rrezikohet të dëmtohet buxheti publik.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-së nuk e ka zbatuar këtë dispozitë duke na diskriminuar neve.
Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

CONEX

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, e bazuar ankesa e GOE ***OE "Conex"L.L.C & "Pepa Group"sh.p.k***

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

v10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

CONEX